



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Datë 12.10.2023]

*Formulari nr. 3*

**FTESË PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Bashkia Tiranë  
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë  
Tel/Fax 0035542256799  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al  
Adresa e Internetit [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Barcelonë -Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **12.10.2023 ora 15.15** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

**1. “Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi Tiranë- Barcelonë -Tiranë”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Barcelonës do të bëhet në datën 17.10.2023 në orën 06.20, mbërritja në Barcelonë në orën 12.50 (Me një ndalesë).
- Nisja nga Barcelona drejt Tiranës do të bëhet në datën 19.10.2023 në orën 22.20, mbërritja në Tiranë në orën 00.50.

(Pa ndalesë, bagazhe të përfshira) .

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) *Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.*

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: [administrative.prokurime@tirana.al](mailto:administrative.prokurime@tirana.al)) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.